



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 14.04.2020

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2021"

(shqyrtimi në parim)

HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*referuar në vijim "Komisioni"*), në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin "Për buxhetin e vitit 2021".

Komisioni caktoi relator për shqyrtimin e projektligjit deputetin z.Bashkim Fino.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar dhe diskutuar në parim projektligjin morën pjesë Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Buxhetit, znj. Mimoza Dhëmbi.

I.BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT, VLERËSIMI KUSHTETUES DHE PROCEDURIAL

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës. Ai paraqitet për shqyrtim dhe miratim bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës. Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

II.OBJEKTIVAT E BUXHETIT 2021

Sipas relacionit të Këshillit të Ministrave, projektbuxheti 2021 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19 përmes skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjes pro-aktive ndaj biznesit, rindërtimit të plotë të banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti si dhe masave parandaluese të

përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Projektbuxheti 2021 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -6.1 përqind, ekonomia pritet të rekuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 5.5 përqind në vitin 2021 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 4.9 përqind përgjatë periudhës afatmesme në vijim. Më specifikisht rritja ekonomike parashikohet në 4.8 dhe 4.5 përqind respektivisht për vitet 2022 dhe 2023. Norma e papunësisë parashikohet me ulje në 2021 në nivelin 12.2% krahasuar me të pritshmin e vitit 2020 prej 13.9%. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 7.2% e PBB.

Defiçiti buxhetor për vitin 2021 planifikohet të jetë në nivelin 6.5% të PBB. Pavarësisht nivelit relativisht të lartë që vjen si pasojë e efekteve negative të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 dhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, deficieti buxhetor vijon të mbështesë ekskluzivisht financimin e investimeve publike. Në fund të vitit 2023, niveli i deficitit buxhetor parashikohet të ulet në 2.3% të PBB duke përmbushur objektivin madhor të Qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik.

Në projektbuxhetin e vitit 2021, programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet. Në vijimësi, projektbuxheti 2021 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2021-2023 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në procesin e rindërtimit si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Projektbuxheti 2021 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore, vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë dhe reformat e ndërmarra deri më tani pritet të kenë impaktin më të madh në organizimin e

administratës publike vendore në funksion të rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore. Në vijim të reformës administrativo-territoriale janë bërë reforma të thella në drejtim të menaxhimit financiar në nivel vendor. Qeveria Shqiptare ka miratuar dhe po zbaton një program ambicioz decentralizimi. Mbështetja që ka dhënë qeveria për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet reformave të ndërmarra, por edhe rritja e konsiderueshme e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ka bërë të mundur që të rriten mbi 2 tre herë investimet dhe shërbimet publike dhe njëkohësisht pesha e buxhetit vendor të rritet nga 2.1% e PBB-së në vitin 2013 në 3.3% të PBB-së në vitin 2021.

III.PRIORITETET 2021-2023 NË FUSHËN E DREJTËSISË

Bazuar në relacionin e Këshillit të Ministrave, Ministria e Drejtësisë për periudhën 2021-2023 do të prioritetizojë:

- Jetësimin e reformës në drejtësi;
- Jetësimin e reformës në drejtësi për të miturit;
- Forcimin e luftës kundër korrupsionit në administratë;
- Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve dhe zonave informale. Rregullimin e çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore;
- Garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe sigurimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri;
- Rritjen e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efektive në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2021-2023

Programi “Sistemi i Burgjeve” synon që të arrijë treguesit e mëposhtëm:

- Norma e recidivitetit (burra) të ketë një trend konstant 18% ndër vite;
- Norma e recidivitetit (gra) të ketë një trend rënës nga 1% që është aktualisht;
- Të dënuar që punësohen pasi fitojnë lirinë të rritet nga 10% e totalit që është aktualisht.

Programi “Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Provave” synon:

- Realizimin e skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 1000 që është aktualisht në 1,600 në 2023;
- Ndarjen e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e

kompensimit duke bërë që të rritet numri subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

IV.OBJEKTIVAT KRYESORË PËR BUXHETIN VENDOR TË VITIT 2021

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2021, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të jetë vazhdimi i konsolidimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore duke u fokusuar në disa drejtime:

- Rritja e burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 2.1 miliard lekë ose 5.3 % më shumë se sa i pritshmi i vitit 2020, rritje e cila sigurohet nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat e tarifave vendore. Kjo rritje krijon hapësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në investime kapitale;
- Forcimi i disiplinës financiare në nivel vendor, nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, duke synuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura;
- Implementimi i metodologjisë së re në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Hartimi i një analize të detajuar mbi numrin e punonjësve dhe strukturave organizative të njësive të vetëqeverisjes vendore në raport me funksionet që u përckaton ligji.
- Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;
- Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij;
- Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët. Kjo, do të arrihet nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative;
- Rritja e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar;
- Përmirësimi i cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor, nëpërmjet përmirësimit të raportimit dhe analizës së financave vendore dhe krijimit të një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës;
- Sigurimi i menaxhimit financiar transparent dhe efektiv për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumentave buxhetorë dhe zhvillimin të

seancave të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët.

V.ÇËSHTJE TË DISKUTUARA LIDHUR ME PROJEKTBUXHETIN NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit në Komision, Ministrija e Financave dhe Ekonomisë znj. Denaj informoi deputetët se projektbuxheti 2021 mbart një objektiv të rëndësishëm të qeverisë shqiptare, atë të rimëkëmbjes ekonomike pas dy fatkeqësive që goditën shoqërinë tonë, si tërmeti dhe pandemia globale e shkaktuar nga virusi COVID-19. Edhe gjatë vitit 2021 rindërtimi do të ketë një fokus të rëndësishëm me mbështetje buxhetore të parashikuar rreth 28 miliard lekë.

Znj. Denaj pasi parashtroi treguesit kryesorë të projektbuxhetit 2021 u ndal tek reforma në drejtësi duke sjellë në vëmendje të anëtarëve të komisionit financimin në vite në mbështetje të kësaj reforme. Duke filluar nga vitit 2017 u financua ngritja e institucioneve të vettingut, u shtua financimi për disa nga institucionet ekzistuese si Shkolla e Magjistraturës dhe Gjykata Kushtetuese, kosto totale me rreth 350 milion lekë. Në vitin 2018 kosto shtesë për vijimin e reformës në drejtësi u miratua me rreth 500 milion lekë, duke financuar funksionimin e plotë të institucioneve të vettingut. Viti 2019 shënon financimin më të lartë krahasuar me dy vitet e mëparshme me një kosto totale të shtuar nga buxheti i shtetit rreth 2.1 miliard lekë. Në vitin 2020 financimi për vijimin e reformës u miratua me 1.5 miliard lekë, konkretisht 0.4 miliard lekë për KLGJ dhe sistemin e gjykatave, 0.3 miliard lekë për funksionimin e plotë të SPAK dhe BKH, 0.1 miliard lekë për ILD, 0.1 miliard lekë për shtesat në KLP, GJK dhe Shkollën e Magjistraturës etj. Këto shifra, sipas znj. Denaj tregojnë fokusin dhe mbështetjen maksimale të qeverisë në mbështetje të kësaj reforme të rëndësishme për vendin tonë duke realizuar mbështetjen në funksionimin e plotë të institucioneve me një numër rreth 668 punonjësish.

Në fund ajo parashtroi disa nga treguesit e shpenzimeve për pushtetin vendor dhe ju përgjigj pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Relatori, z. Fino u shpreh se buxheti i viteve 2020-2021 do të mbahet mend në historikun e financave publike dhe në memorijen e popullit shqiptar si buxheti që ka rikuperuar 100% dëmtimet e shtëpive dhe banesave të shkaktuara nga dy goditjet fatkeqe të tërmetit të shtatorit dhe nëntorit të vitit 2019. Nga ana tjetër, projektbuxheti i vitit 2021 ndonëse përkon me një vit elektoral nuk ka karakteristika aspak të tipareve elektorale, pra është një buxhet normal pune. Sipas z. Fino, buxheti i vitit 2021 mbështet, orienton dhe nxit reformat e nisura dhe reformat që po ndërmarrin dhe që e bëjnë përmirësimin cilësor të qeverisjes dhe zhvillimit ekonomik. Në mbështetje të vlerësimeve të bëra më lart, ai parashtroi për anëtarët e komisionit argumentat e mëposhtme:

Së pari, projektbuxheti i rindërtimit të banesave të shkatërruara nga tërmeti i vitit 2019 dhe i rikuperimit të pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID 19 tregon qartë se gjatë vitit 2021 do të rivendoset normaliteti ekonomik në Shqipëri.

Së dyti, projektbuxheti i vitit 2021 synon objektivat e qeverisë për rimëkëmbjen e ekonomike, si dhe mbajtjen në kontroll të tregut buxhetor, siç janë deficitet buxhetor dhe borxhi publik. Ky projekt synon të shpërndajë në mënyrë sa më të drejtë barrën fiskale, duke ulur

ngarkesën në grupe e sektorë të caktuar. Me gjithë recesionin, rënien ekonomike që parashikohet të jetë minus 6,1%, janë të mbrojtur dhe të garantuar tregues të tjerë që garantojnë stabilitet të financave publike, siç është deficitin primar, rritja ekonomike me tregues pozitivë dhe investimet publike, konsumi e të tjerë.

Së treti, nga pikëpamja e metodologjisë së hartimit dhe të zbatimit ky projektbuxhet reflekton ndryshimin që kërkon koha për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e pandemive të ndryshme. Këto fenomene natyrore dhe jonatyrore na kanë detyruar ta ndryshojmë disa herë buxhetin gjatë vitit 2020, të ndryshojmë sjelljen tonë të përditshme dhe qëndrimin social, për rrjedhojë këto kanë gjetur pasqyrim në këtë projektbuxhet, me qëllim rritjen e sigurisë civile dhe shëndetësore si garanci për rritjen e sigurimit të kushteve për zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit. Dëshmi e qartë e kësaj filozofie në këtë projektbuxhet janë fondet e rindërtimit që kapin një shumë të konsiderueshme 28 miliardë lekë, ose 24% të totalit të investimeve publike, fondet në fushën e sektorit anti-COVID dhe fondet për mbrojtjen civile akorduar bashkive në masën rreth 500 milionë lekë.

Së katërti, ky projektbuxhet vazhdon të mbështesë një ndër reformat më të rëndësishme për shqiptarët e vendit tonë, reformën në drejtësi. Reforma në drejtësi vazhdon të marrë një mbështetje madhore buxhetore. Buxheti i të gjitha organeve dhe institucioneve të drejtësisë ka pësuar rritje, që nga viti 2017, sidomos në vitin 2021, duke garantuar vazhdimin normal të punës së tyre.

Së pesti, projektbuxheti i vitit 2021, megjithëse me burime të kufizuara për shkak të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i vitit të kaluar dhe nga COVID-i i këtij viti, vazhdon të mbështesë pushtetin vendor. Pavarësisht recesionit të këtij viti dhe ritmit të ulët ekonomik që parashikohet për vitin e ardhshëm, financimi nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor jo vetëm që nuk ka pësuar ulje, përkundrazi, është rritur. Sipas produktit të brendshëm bruto për vitin 2021, transfertat e pakushtëzuar duhej të ishte 1,4 miliardë lekë më e vogël se këtë vit dhe, pavarësisht kësaj, jo që nuk ka pësuar ulje, por ka një rritje të lehtë me rreth 1,3% më të lartë se ajo e vitit 2020, ose, nëse e krahasojmë me vitin 2013 është 50% më e lartë. Në përgjithësi, burimet e financimit vendor janë 5,3% më të larta se ato të vitit 2020 dhe, krahasuar me ato të vitit 2013, janë dy herë më të mëdha. Është për t'u veçuar fakti se për herë të parë bashkitë do të marrin 800 milionë lekë më shumë për buxhetet e tyre nga tatimi mbi të ardhurat personale që vjen nga zbatimi i ligjit të financave vendore, dhe kjo është shumë e rëndësishme të thuhet.

Së fundi, projektbuxheti i vitit 2021 konfirmon rikonsolidimin e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë duke siguruar punësimin, sipërmarrjen, pensionistët, nxënësit dhe studentët se Shqipëria do të jetë më e fortë, më e mirë, më e stabilizuar dhe, mbi të gjitha, më e aftë për të ofruar zhvillim dhe mirëqenie.

Duke përfunduar relatori, z. Fino, ftoi anëtarët e komisionit që ta miratojnë projektbuxhetin në parim.

VI.PËRFUNDIME

Pas përfundimit të diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, duke konstatuar se:

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, në përputhje me afatet e përcaktuara në kalendarin e Kuvendit “Për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021””, bazuar në nenet 79 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATOR

KRYETAR

BASHKIM FINO

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë më 10.11.2020

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”
(Shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjet e datave 9 dhe 10 nëntor 2020, bëri prezantimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2021” dhe zhvilloi seanca dëgjimore nëpërmjet platformës online Cisco Eëbex, me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e pavarura të krijuara me ligj, sipas fushës së veprimtarisë, në përgjegjësinë e këtij Komisioni, konkretisht me:

1. *Gjykatën Kushtetuese;*
2. *Prokurorinë e Përgjithshme;*
3. *Shkollën e Magjistraturës;*
4. *Këshillin e Lartë Gjyqësor;*
5. *Këshillin e Lartë të Prokurorisë;*
6. *Inspektorin e Lartë të Drejtësisë;*
7. *Strukturën e Posacme Anti Korrupsion;*
8. *Kolegjin e Posaçëm të Apelimit;*
9. *Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;*
10. *Institucionin e Komisionerëve Publikë;*
11. *Institucionin e Presidentit;*
12. *Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;*
13. *Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;*
14. *Avokatin e Popullit;*
15. *Komisionin e Prokurimit Publik;*
16. *Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;*
17. *Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
18. *Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;*
19. *Autoritetin Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;*
20. *Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit;*
21. *Ministrinë e Drejtësisë;*
22. *Ministrinë e Brendshme (Gjendja Civile, Çështjet Vendore dhe Prefekturat);*

23. Shoqatat përfaqësuese të njëjësive të vetqeverisjes vendore;

Pas prezantimeve të kërkesave buxhetore nga titullarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të pavarura të krijuara me ligj, Komisioni konstatoi se:

1. Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese

Kërkesat buxhetore u parashtruan nga Drejtori i Financës i Gjykatës Kushtetuese, i cili për projektbuxhetin e vitit 2021, kërkoi që të merren parasysh kërkesat e mëposhtme:

- shtesë në organikë me 10 punonjës dhe shtesë përkatëse në fondin e pagave e sigurimeve shoqërore për këta punonjës prej 22,800 mijë lekë;
- shtesë në zërin e mallrave dhe shërbimeve prej 9,500 mijë lekë për përmbushjen e plotë të nevojave të institucionit;
- shtesë në zërin e shpenzimeve kapitale me 22,000 mijë lekë që do shërbejnë dhe për rikonstrukcionin e ambienteve të brendshme të gjykatës, vazhdimësinë e projektit për rinovimin e parkut të automjeteve, projektin e ri të rikonstrukcionit të sallës së bibliotekës, për sistemin elektronik të e ruajtjes e sigurisë së brendshme, etj.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vlerësoi se fondet e parashikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” janë të mjaftueshme për të garantuar funksionimin normal të tij, kjo referuar realizimit që ky institucion ka patur në veçanti për sa i takon zërit të investimeve në buxhetin e vitit 2020.

2. Për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme

Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme bëri një prezantim të përgjithshëm të buxhetit për vitin 2021, për këtë institucion. Ai theksoi se nëpërmjet miratimit të këtij buxheti garantohet rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime me 110 milion lekë dhe investimeve me 50 milion lekë, duke plotësuar më së miri të gjitha nevojat e institucionit. Për këto arsye nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme nuk u parashtrua asnjë kërkesë për shtesë në fondet buxhetore që i janë alokuar, nga Ministria e Financave.

3. Për projektbuxhetin e Shkollës së Magjistraturës

Në mbledhjen e Komisionit morri pjesë Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, i cili për projektbuxhetin e vitit 2021 për këtë institucion kërkoi që të merren parasysh kërkesat e mëposhtme:

- shtesë prej 6,187 milion lekë në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për punësimin e katër punonjësve shtesë: 1 këshilltar për publikimet shkencore, 1 specialit IT, 1 sekretar titullari dhe 1 nëpunës informacioni;
- shtesë prej 74,268 milion lekë për përballimin e 50% të bursave të kandidatëve për magjistratë të vitit të parë dhe të dytë dhe përballimin e bursave për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;

- Shtesë në shpenzimet kapitale në vlerën 138,025 milion lekë, për ndërtimin e godinës së re të Shkollës.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës, shtesat e mëposhtme:

- Shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për përballimin e dy punonjësve shtesë, në vlerën 1,5 milion lekë;
- Shtesë në vlerën 60 milion lekë në zërin transferta për individët dhe bursat, për përballimin e 50% të bursave të kandidatëve për magjistratë të vitit të parë dhe të dytë dhe përballimin e bursave për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;

4. Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Prezantimi i projektbuxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor u parashtrua nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Naureda Llagami. Përfaqësuesit e KLGJ-së gjatë prezantimit të projektbuxhetit të vitit 2020 si organ qeverisës i sistemit gjyqësor, vlerësuan rritjen e zërave të vecantë të buxhetit sic është dhe rritja e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore me 275 milion lekë, për punësimin e 86 punonjësve shtesë në krahasim me një vit më parë dhe rritja me 30 milion lekë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Edhe pse parimisht dakord përfaqësuesit e institucionit kërkuan që Komisioni të marrë parasysh edhe kërkesat e mëposhtme për buxhetin e KLGJ-së:

- Rritjen e shpenzimeve operative në masën 127,8 milion lekë, për mirëmbajtjen e programit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, për shtesën në fondin për shërbimin e rojeve, për shpenzimet operative të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
- Fondet buxhetore, për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit, që do të ngrihet pranë KLGJ-së.

Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vlerësoi se fondet e parashikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” janë të mjaftueshme për të garantuar funksionimin normal të tij, duke mos miratuar kërkesat për shtesa në zërin e shpenzimeve operative.

5. Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Prezantimi i projektbuxhetit për Këshillin e Lartë të Prokurorisë u parashtrua nga Kryetari i këtij institucioni, z. Gent Ibrahim, i cili i parashtroi Komisionit kërkesat e mëposhtme:

- shtesë punonjësish në strukturën e KLP, konkretisht 6 shoferë për të siguruar shofer për secilin nga anëtarët e KLP, të cilët kanë statusin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë;
- shtesë në fondin e shpenzimeve operative në zërat: shpenzime pritje-përcjellje, shpenzime të ruajtjes dhe sigurisë së institucionit, shpenzime të energjisë elektrike, shpenzime pastrimi, etj;

Lidhur me kërkesat e paraqitura vlerësohet se fondet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2021, garantojnë funksionimin normal të institucionit, në përmbushje të kompetencave të tij ligjore duke qënë se janë parashikuar fonde në vlerën 20 milion lekë më shumë se në buxhetin e vitit 2020.

Komisioni miratoi vetëm shtesën prej 3 milion lekë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, e cila do të sigurohet nga zvogëlimi me të njëjtën vlerë të zërit të investimeve të parashikuara.

6. Për projektbuxhetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Prezantimi i projektbuxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit u parashtrua nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Albana Shtylla. Përfaqësuesit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë seancës dëgjimore në Komision u kërkua shtesë në total 72.6 milion lekë, si më poshtë:

- Për shpenzimet në paga kërkohen 59.9 milion lekë, për:
 - a) shtesën e personelit me rreth 12 punonjës 9 këshilltarë në Njësinë e Shërbimit Ligjor (nga të cilët 5 këshilltarë ligjorë dhe 4 këshilltarë ekonomik), 3 punonjës në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
 - b) Shpenzimet për vjetërsinë e këshilltarëve;
 - c) Shpenzimet për orët shtesë,
 - d) Shpenzim për rritje e pagave për 3 poste aktuale pune specialistë.
- Për shpenzimet në investime kërkohen 12.7 milion lekë, kërkesa vjen për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë të parashikuar, mobilje dhe pajisje zyre dhe scanner për kontroll dhe urë metali dedektor.

Lidhur me kërkesat e paraqitura u vlerësua nga Komisioni se fondet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2021, garantojnë funksionimin normal të institucionit, në përmbushje të kompetencave të tij ligjore, për këtë arsye Komisioni vendosi të mos miratojë kërkesën për shtesë të numrit të punonjësve, ndërsa kërkesa për përllogaritjen e pagesës së vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor do të sigurohet me VKM që pritet të miratohet së shpejti.

7. Për projektbuxhetin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Prezantimi i projektbuxhetit për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, u parashtrua nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Qirko dhe përfaqësues të këtij institucioni. Përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë seancës dëgjimore në komision parashtruan kërkesën për:

- Shtesë të fondit të pagave me rreth 131 milion lekë. Kërkesa vjen si pasojë e:
 - a. nevojës për shtimin e 12 këshilltarë juristë
 - b. për përllogaritjen e pagesës së vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor,
 - c. dhënien e dy pagesave në vit për vështirësi dhe
 - d. Pagesa e orëve shtesë jashtë orarit zyrtar për stafin administrativ.

Lidhur me kërkesat e paraqitura u vlerësua nga Komisioni se fondet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2021, garantojnë funksionimin normal të institucionit, në përmbushje të kompetencave të tij ligjore, për këtë arsye Komisioni vendosi të mos miratojë kërkesën për shtesë të numrit të punonjësve, ndërsa kërkesa për përllogaritjen e pagesës së vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor do të sigurohet me VKM që pritet të miratohet së shpejti.

8. Për projektbuxhetin e Institucionit të Komisionerëve Publikë

Prezantimi i projektbuxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë u parashtrua nga Komisioneri z. Florjan Ballhysa. Komisioneri Publik, gjatë seancës dëgjimore në komision shprehu kërkesën për shtesë në fondin e pagave me 4.6 milion lekë si pasojë e përlllogaritjes së fondit të nevojshëm për të përballuar shpenzimet në paga.

Lidhur me kërkesat e paraqitura u vlerësua nga Komisioni se fondet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2021, garantojnë funksionimin normal të institucionit, në përmbushje të kompetencave të tij ligjore, për këtë arsye Komisioni vendosi të mos miratojë kërkesën për shtesë të numrit të punonjësve, ndërsa kërkesa për përlllogaritjen e pagesës së vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor do të sigurohet me VKM që pritet të miratohet së shpejti.

9. Për projektbuxhetin e Inpektorit të Lartë të Drejtësisë

Buxheti për institucionin e ILD u prezantua nga Kryeinspektori z. Artur Metani, i cili ndër të tjera theksoi se buxheti total i parashikuar për vitin 2021, për ILD është 245 milion lekë dhe krahasuar me një vit më parë rezulton se gjitha zërat kanë pësuar rritje të konsiderueshme, kështu është rritur fondi i pagave me 95.8 mln lekë, janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 4 mln lekë dhe janë shtuar 45 milion në investime për të përballuar kërkesat shtesë.

Duke marrë në konsideratë nevojat emergjente që ka buxheti për rindërtim, ILD vendosi të mos paraqesë asnjë kërkesë për shtesë fondesh buxhetore, Komisioni vendosi të miratojë një shtesë në zërin e shpenzimeve operative në masën 15 milion lekë, për ILD-në.

10. Për projektbuxhetin e Strukturës së Posacme Antikorrupsion

Në mbledhjen e Komisionit, për të prezantuar buxhetin e SPAK ishin të pranishëm z. Arben Kraja dhe znj. Aida Hajnaj. Buxheti total i parashikuar për vitin 2021 për SPAK është 500 milion lekë, nga të cilat:

- 380,7 milion lekë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore të 164 punonjësve;
- 84,9 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 30 milion lekë shpenzime kapitale.

Drejtuesit e SPAK, ishin dakord me projektbuxhetin e akorduar për këtë institucion, i cili akomodon të gjitha nevojat vjetore dhe nuk paraqitën kërkesa shtesë.

11. Për projektbuxhetin e Institucionit të Presidencës

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, instiucioni i Presidencës u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithëm znj. Ornela Zonja dhe këshilltari i Presidentit z. Petraq Milo, të cilët ishin dakord me projektbuxhetin e Institucionit të Presidencës dhe nuk paraqitën kërkesa shtesë mbi fondet e akorduara nga Ministria e Financave.

Buxheti total i parashikuar për vitin 2021, për Presidencën është 248,5 milion lekë dhe nga ku rezulton se shpenzimet për paga janë rritur me 2 milion lekë, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 11,2 milion lekë.

12. Për projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, përfaqësuesit e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit nuk paraqitën kërkesa për fonde shtesë.

13. Për projektbuxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Në mbledhjen e Komisionit Kryekomisioneri z. Ilirjan Celibashi paraqiti kërkesat për këtë institucion, si më poshtë:

- Shtesë e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për 14 punonjës shtesë, sipas strukturës së miratuar nga Kuvendit së fundmi për punonjësit me kohë të plotë pune të KQZ-së. kjo shtesë llogaritet të ketë një vlerë prej 29 milion lekë;
- Shtesë në zërin e investimeve për blerje pajisje kompjuterike në vlerën 23 milion lekë;
- Shtesë në zërin e investimeve për rikonstruksionin e godinës së institucionit në vlerën 18, 2 lekë.

Komisioni miratoi shtesën në zërat e pagave dhe sigurimeve shoqërore në vlerën 29 milion lekë; shtesën në zërin e investimeve në vlerën 25 milion lekë, nga të cilat 15 milion lekë për blerje pajisje kompjuterike dhe 10 milion lekë për rikonstruksionin e godinës.

14. Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit:

Në mbledhjen e Komisionit, institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua nga znj. Erinda Ballanca, e cila paraqiti kërkesat e mëposhtme:

- Shtesë të shpenzimeve për paga prej 3,82 milion lekë, për tre Ndhmëskomisioner;
- Rritjen me 5 milion lekë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për realizimin e disa aktiviteteve;
- Rritjen e shpenzimeve kapitale me 11 milion lekë për:
 - a. Pajisje Zyrash – 1 milion lekë,
 - b. Pajisje/kompjuterë - 1 milion lekë,
 - c. Studim për rehabilitimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme të Institucionit – 2 milion lekë,
 - d. Automjete të reja – 3 milion lekë
 - e. Projektim, implementim, dhe mirëmbajtje për sistemin DocuLive – 4 milion lekë.

Komisioni vendosi të miratojë për Avokatin e Popullit shtesën prej 1 milion lekë në zërin e investimeve dhe në vijim të vitit buxhetor do shikohet dhe mundësia për miratimin e kërkesës për rikonstruksionin e godinës.

15. Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioni u njoh me prezantimin e projektbuxhetit nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili paraqiti kërkesën për: fonde shtesë në zërin investime në vlerën 3 milion lekë, për përfundimin e realizimit të përshtatjes së ndërtesës me elementet e PAK, procedurë e filluar me fondet e akorduara në vitin 2019.

Komisioni vendosi të miratojë kërkesën e Komisionerit për shtesë 3 milion të zërit të investimeve, për aksesueshmërinë e institucionit për personat me aftësi ndryshe.

16. Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Komisioni u njoh me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi, i cili paraqiti kërkesë për shtesë strukture për 7 punonjës me qëllim përmbushjen e funksioneve të këtij institucioni në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”, monitorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale nga organet ligjzbatuese.

Komisioni, duke pasur parasysh që rritja e kërkuar e numrit të punonjësve është reflektuar në dy vitet e fundit në ligjin e buxhetit, vendosi të miratojë kërkesën e Komisionerit, duke kërkuar reflektimin sa më parë në strukturën e miratuar nga Kuvendi.

17. Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Në mbledhjen e Komisionit, Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha, u shpreh se projektbuxheti i vitit 2021 plotëson kërkesat e këtij institucioni, dhe nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë.

18. Për projektbuxhetin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Në seancën dëgjimore ishte prezent për të prezantuar strukturën e institucionit Kryetarja e Autoritetit, e cila paraqiti kërkesat si vijon:

- Rritjen e numrit të miratuar të punonjësve për vitin 2021
 - a. Plotësimi i organikës me 10 punonjës
 - b. Shtesë në strukturë të 5 punonjësve.
- Rritjen e fondeve buxhetore të investimeve për:
 - a. Për blerjen e pajisjeve kompjuterike
 - b. Për blerjen e mobiljeve të zyrës
 - c. Tvsh e projektit të rikonstruksionit
 - d. Fonde për përfundimin e rikonstruksionit të godinës.

Komisioni vendosi të miratojë shtesën prej 10 punonjësish, sic është miratuar në strukturë dhe rritjen e fondeve për pajisje zyre dhe shtesës për tvsh, në zërin e investimeve në vlerën 10 milion lekë.

19. Për projektbuxhetin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Buxheti i ISKPK u paraqit në Komision nga z. Celso Hoxha, Drejtor Ekzekutiv, i cili vlerësoi se fondet e akorduara për këtë institucion në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” akomodojnë nevojat për garantimin e funksionimit normal të këtij institucioni.

20. Për projektbuxhetin e Komisionit të Prokurimit Publik

Buxheti i institucionit u prezantua në Komision nga Kryetari i KPP, z. Jonaid Myziri, i cili parashtrroi kërkesat e mëposhtme buxhetore:

- Rritjen e zërit të shpenzimeve operative me 2 milion lekë për përbalimin e trajnimit të stafit të Komisioni dhe
- Implementimin e projektit informatik të digjitalizimit të ankesave në vlerë 180 milion lekë.

Komisioni vendosi të miratojë vetëm kërkesën e parë, për rritje të shpenzimeve operative me vlerën 2 milion lekë.

21. Për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë

Buxheti total i parashikuar për vitin 2021, për Ministrinë e Drejtësisë arrin në 9208,7 milion lekë, nga të cilat:

- 4996, 8 milion lekë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, përfshirë dhe rritjen e pagave për 3359 punonjës të policisë së burgjeve;
- 1456, 2 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 2008 milion lekë për transferta të brendshme korrente;
- 653, 9 milion lekë për investime.

Ministria e Drejtësisë për periudhën 2021-2023 do të prioritetizojë:

- Forcimin e Luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- Rregullimi i çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore;
- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe siguron ri-integrimin e tyre në shoqëri;
- Rritja e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

Ministria e Drejtësisë nuk paraqiti kërkesa shtesë mbi fondet e akorduara nga Ministria e Financave.

22. Për projektbuxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për pjesën e gjendjes civile, çështjet vendore dhe prefekturat dhe Buxheti Vendor

Projektbuxheti i vitit 2021, megjithëse me burime të kufizuara për shkak të dëmeve të shkaktuara nga tërmetet e vitit të kaluar dhe Covid-19, vazhdon të mbështesë pushtetin vendor. Pavarësisht recesionit të këtij viti dhe ritmit të ulët ekonomik që parashikohet për vitin e ardhshëm, financimi nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor, jo vetëm që nuk ka pësuar ulje por përkundrazi është rritur. Sipas PBB për vitin 2021, transferta e pakushtëzuar duhet të ishte 1.4 miliard lekë më e vogël se ajo e akorduar në vitin 2020. Pavarësisht kësaj, ajo jo vetëm që nuk ka pësuar ulje por ka një rritje të lehtë me rreth 1.3% më e lartë se ajo e vitit 2020. Nëse e krahasojmë me vitin 2013, transferta e këtij viti është mbi 50% më e lartë. Është për tu vecuar fakti se për herë të parë bashkitë do të marrin 800 milion lekë më shumë për buxhetet e tyre nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale që vjen nga zbatimi i ligjit për financat vendore.

Ky projektbuxhet vazhdon mbështetjen për arsimin parashkollor, konkretisht për 440 edukatorë më shumë në sistem se sa në vitin 2018 dhe 32 staf mbështetës se sa në vitin 2019.

Në mbledhjen e Komisionit përfaqësuesit e Shoqatave për Autonominë Vendore, paraqitën kërkesat përfshirë këtu dhe rishikimin e mënyrës së shpërndarjes së tatim fitimit, duke kaluar nga një ndarje e tatimit bazuar në numrin e popullsisë në një ndarje sipas bashkisë ku krijohet tatimit dhe rishikimi i stokut të borxhit i cili pas ndarjes administrative ka pësuar ulje të ndjeshme nga 12 miliard në 8 miliard lekë, por ngelet akoma shqetësues. Shoqatat e Bashkive kanë kërkuar mundësinë e faljes së këtij borxhi.

Për sa i takon buxhetit të njërive të vetqeverisjes vendore, pas shqyrtimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve të paraqitura nga shoqatat përfaqësuese të njërive të vetqeverisjes vendore, dhe bazuar në parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Komisioni vendosi t’i përcjellë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat rekomandimin për të bërë ndryshimeve e nevojshme ligjore si në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat" ashtu dhe në ligjin "Për financat e vetqeverisjes vendore", me qëllim shpërndarjen e tatimit në vendin ku krijohet.

Të gjitha ndryshimet e miratuara më sipër nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të reflektohen në tabelën 1 të projektligjit “Buxheti 2020 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve të buxhetore”, si dhe në tabelën 2 që parashikon numrin e punonjësve për vitin 2020.

RELATOR

Bashkim FINO

KRYETAR

Ulsi MANJA